

CONAD FOOD TRADE sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5 – 29

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	6	201,295,641	253,108,837
Aktivitet afatgjata jomateriale	7	7,587,489	27,672,092
Parapagime afatgjata	8	12,234,270	7,724,310
Investime në ambiente të marra me qira	9	72,496,039	92,591,510
Totali i aktiveve afatgjata		293,613,439	381,096,749
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	10	254,961,877	278,172,950
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	20,797,107	14,171,700
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	12	60,414,957	27,755,058
Llogari të arkëtueshme të tjera	13	6,518,366	9,369,060
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	14	7,221,127	7,143,377
Mjetet monetare në arkë e në bankë	15	136,087,428	127,380,640
Totali i aktiveve afatshkurtra		486,000,862	463,992,785
Totali i aktiveve		779,614,301	845,089,534
KAPITALI			
Kapitali themeltar		148,963,500	148,963,500
Rezerva ligjore		2,974,975	1,101,320
Fitime të mbartura		21,765,887	(13,833,551)
Fitimi i ushtrimit		86,633,938	37,473,093
Totali i kapitalit	16	260,338,300	173,704,362
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	-	10,382,973
Hua afatgjata nga ortaku	18	55,595,845	59,888,734
Totali i detyrimeve afatgjata		55,595,845	70,271,707
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	19	8,025,123	26,434,425
Llogari të pagueshme tregtare	20	69,499,746	85,424,562
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	21	342,552,002	450,016,907
Parapagimet e arkëtuara	22	73,563	75,678
Detyrime tatimore	23	33,924,899	29,916,090
Llogari të pagueshme të tjera	24	9,604,823	9,245,803
Totali i detyrimeve afatshkurtra		463,680,156	601,113,465
Totali i detyrimeve		519,276,001	671,385,172
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		779,614,301	845,089,534

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	25	2,419,967,952	2,319,702,863
Të ardhura të tjera	26	30,918,635	36,662,068
Total të ardhura		2,450,886,587	2,356,364,931
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	27	(1,843,726,001)	(1,789,383,156)
Shpenzime personeli	28	(128,056,104)	(118,461,928)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	29	(96,063,127)	(94,561,053)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	30	(286,965,483)	(311,092,315)
Total shpenzime		(2,354,810,715)	(2,313,498,452)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	31	(248,437)	(1,844,841)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	32	6,562,305	2,790,086
Fitimi para tatimit		102,389,740	43,811,724
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(15,755,802)	(6,338,631)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	33	(15,755,802)	(6,338,631)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi i vitit		86,633,938	37,473,093
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		86,633,938	37,473,093

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

CONAD FOOD TRADE sh.p.k*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	148,963,500	1,101,320	10,640,563	(24,474,114)	136,231,269
Fitimi i vitit				37,473,093	37,473,093
Transferim në fitime të mbartura			(24,474,114)	24,474,114	-
Transferim në rezervë ligjore					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	148,963,500	1,101,320	(13,833,551)	37,473,093	173,704,362
Fitimi i vitit				86,633,938	86,633,938
Transferim në fitime të mbartura			35,599,438	(35,599,438)	-
Transferim në rezervë ligjore		1,873,655		(1,873,655)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	148,963,500	2,974,975	21,765,887	86,633,938	260,338,300

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më ____ mars 2019 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Znj. Artenida Dule

Përgatitës i pasqyrave financiare



Z. Pietro Tafuni
Administrator




CONAD FOOD TRADE sh.p.k
(Vlerat janë në Lekë)
**Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	102,389,740	43,811,724
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizimi	71,717,591	80,873,813
Rimarrje kuotash nga investimet ne ndertime te marra me qera	22,560,708	-
Zhvlerësimi	1,784,828	-
Shpenzime per interesa	272,256	1,854,398
Tatimi mbi fitimin	(15,755,802)	(6,338,631)
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues		
Rënie/(rritje) në inventar	23,211,073	14,173,107
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(38,219,441)	127,357,575
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	(108,474,062)	(92,410,722)
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(7,052,947)	(4,812,172)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	52,433,944	164,509,092
Interesa të paguara	(272,256)	(1,854,398)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(10,549,944)	(573,789)
	(10,822,200)	(2,428,187)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(7,836,444)	(43,713,256)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	8,016,652	4,549,978
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	180,208	(39,163,278)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto huave afatgjatë	(14,675,862)	(27,549,227)
(Ripagim)/ të hyrat neto huave afatshkurtër	(18,409,302)	(108,403,449)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(33,085,164)	(135,952,676)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	8,706,788	(13,035,049)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	127,380,640	140,415,689
Mjetet monetare në fund të periudhës	136,087,428	127,380,640

15

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "CONAD FOOD TRADE" është regjistruar me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë datë 03/04/2006. NIPT-i shoqërisë është K61704029H.

Shoqëria ka si objekt menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, ndërtimin, dhënien me qira ose në menaxhim, sikurse edhe shitjen e aktiviteteve tregtare me shumicë apo me pakicë dhe të veprave, strukturave që kanë lidhje me keto aktivitete; ndërtimin, menaxhimin dhe shitjen e dyqaneve për shitje të mallrave me shumicë ose pakicë, për llogari të vet apo të të tretëve; blerjen e mallrave ushqimore të përgjithshme, në bashkëpunim me shoqëri dhe entitete të tjera, si dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme që do të jenë objekt i aktivitetit tregtar.

Më datë 07.03.2019 shoqëria vendosi të ndryshojë emrin nga FOOD TRADE shpk në CONAD FOOD TRADE shpk.

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 148,963,500 lekë i cili zotërohet nga ortakët e Shoqërisë:

1. Luan Leka zotëron 88% të kapitalit ose 131,087,880 lekë.
2. Conad Adriatico Societa Cooperativa zotëron 12% të kapitalit ose 17,875,620 lekë.

Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në autostradën Tiranë-Durrës, km. 6 Kashar, Tiranë. Administratori i Shoqërisë është z.Pietro Tafuni.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 219 punonjës (2017: 231).

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiare"

Shoqëria ka adoptuar SNRF 9, Instrumentat Financiar, nga 1 janar 2018. Kompania zgjodhi të mos rishikojë shifrat krahasuese dhe ka njohur çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare në fitimet e mbartura të hapura që nga data e zbatimit fillestar të standardeve, më 1 janar 2018. Si rrjedhojë, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentat Financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese është zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit ato informacione shpjeguese të bëra në vitin paraardhës.

Adoptimi i SNRF 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët"

Shoqëria vendosi të aplikojë metodën e thjeshtëzuar të kalimit në SNRF 15 dhe zgjodhi të zbatojë mjetet praktike të disponueshme për këtë kalim. Kompania aplikon SNRF 15 vetëm për kontratat që nuk ishin plotësuar deri më datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018).

Adoptimi i SNRF 15 nuk rezulton në korrigjime të pasqyrave financiare për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Kontabiliteti për modifikimin e kontratës: Kompania nuk ka pasur ndonjë ndryshim të kontratës për shkak të natyrës së kontratës ose shumave të arkëtueshme.
- Detyrime të performancës shtesë të identifikuara: Kompania siguron vetëm një detyrim për performance të veçantë, shitjen e mallrave.
- Kontabilizimi për komponentë të rëndësishëm të financimit: Kompania nuk ka kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti e tejkalon një vit.
- Kontabiliteti për programet e besnikërisë së klientit: Shoqëria në kontratat me klientët e saj ka parashikuar zbritje me plotësimin e kushteve të volumit të mallrave të tregtuar gjatë vitit. Këto zbritje janë në baza vjetore dhe reflektohen brenda vitit financiar dhe për pasojë nuk kanë efekte në përputhje me SNRF 15.
- Ndryshimet në kohën e njohjes së të ardhurave (nga përgjatë kohës në një pikë në kohë ose anasjelltas): Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në periudhën kontabël në të cilën behet dhe transferimi i kontrollit mbi mallrat e shitura. Koha e njohjes së të ardhurave mbetet e ngjashme me SNK 18.
- Kontabilizimi për rimbursimet: Kompania nuk zbaton rimbursime.
- Kontabilizimi për kostot e marrjes së kontratës: Shoqëria nuk ka ndonjë kosto për të marrë një kontratë.
- Kontabilizimi për kostot e realizimit të kontratës: Shoqëria nuk ka asnjë kosto për të përmbushur një kontratë.
- Paraqitja e aktiveve dhe detyrimeve të kontratës: Aplikimi i SNRF 15 nuk ka ndonjë ndikim në Shoqëri që do të çonte në njohjen e një aktivi apo detyrime të kontratës.

Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi për Shoqërinë më 1 janar 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në shoqëri:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur njësia ekonomike së pari aplikon SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Kompania planifikon ti aplikojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

3.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operacionale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç nëse aktivi nëfjalë është me vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesi për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënësit. Ndaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera të zakonshme ose qera financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qerasë. Shoqëria ka vendosur zbatimin e standardit nga data e saj e adoptimit të detyrueshëm, data 1 janar 2019 duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shifrave krahasuese.

Tabela në vijim paraqet një rakordim të angazhimeve të qirasë operative të detyrimit të njohur:

	31 dhjetor 2018 / 1 Janar 2019
Pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operacionale që nuk mund të anulohen (Shënimi 27)	416,787,945
Pagesat e ardhshme të qirasë që duhet të paguhet në periudhat që u nënshtrohen opsioneve të shtrirjes së qirasë që janë të arsyeshme për t'u ushtruar	363,464,380
- Pagesat e ardhshme me pagesa qiraje të ndryshueshme që bazohen në një indeks ose një normë	0
- Efekti i skontimit në vlerën aktuale	53,323,565
Detyrimet totale të qirasë	416,787,945

Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të tij, janë paraqitur më poshtë:

- KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 Janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/Lek	107.82	111.10

4.2 Instrumenta financiare

Politika të aplikueshme nga 1 janar 2018

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivitetet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivitetet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivitetet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivitetin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrë se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivitetet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësi ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

- **Detyrimet financiare – kategorite e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

- **Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

- **Kompensimi i instrumenteve financiare.** Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogarit, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Politika të aplikueshme para 1 janar 2018

Instrumentet financiare jo-derivative përfshijnë të arkëtueshmet e tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, për shkak të detyrimeve dhe detyrimeve të tjera.

Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të drejtpërdrejtë që i atribuohet, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit shkojnë direkt në pasqyrën e ardhurave gjithëpërfshirëse. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Kompanisë ndaj flukseve të mjeteve monetare nga aktivet financiare mbarojnë ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa mbajtur kontrollin ose në thelb janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare trajtohen në datën e tregtimit, dmth. datën që Kompania angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Kompanisë të specifikuar në kontratë përfundojnë ose shkarkohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(Vlerat janë në Lekë)

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skanton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.13. Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.14. Krahasueshmëria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje aktiviteti financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kriterëve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredise

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

	<u>Mjete transporti</u>	<u>Mobilje e pajisje zyre</u>	<u>Totali</u>
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2017	16,157,877	461,934,252	478,092,129
Shtesa	1,107,006	42,118,663	43,225,669
Pakësime	-	(4,758,904)	(4,758,904)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	17,264,883	499,294,011	516,558,894
Shtesa	335,820	7,500,624	7,836,444
Transferime			-
Pakësime		(21,727,006)	(21,727,006)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	17,600,703	485,067,629	502,668,332
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2017	8,608,595	200,400,507	209,009,102
Amortizimi i vitit	1,677,677	56,073,958	57,751,635
Zhvlerësim City Park		(2,541,671)	(2,541,671)
Pakësime		(769,009)	(769,009)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	10,286,272	253,163,785	263,450,057
Amortizimi i vitit	1,402,621	50,442,950	51,845,571
Pakësime		(13,922,937)	(13,922,937)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	11,688,893	289,683,798	301,372,691
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,978,611	246,130,226	253,108,837
Gjendja më 31 dhjetor 2018	5,911,810	195,383,831	201,295,641

7. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale paraqitet si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2017	131,992,550	131,992,550
Shtesa	487,587	487,587
Pakësime		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	132,480,137	132,480,137
Shtesa		-
Pakësime	(703,386)	(703,386)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	131,776,751	131,776,751
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2017	84,999,163	84,999,163
Amortizimi i vitit	19,808,882	19,808,882
Kthim amortizimi		-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	104,808,045	104,808,045
Amortizimi i vitit	19,872,020	19,872,020
Kthim amortizimi	(490,803)	(490,803)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	124,189,262	124,189,262
Gjendja neto më 31 dhjetor 2017	27,672,092	27,672,092
Gjendja neto më 31 dhjetor 2018	7,587,489	7,587,489

8. Parapagime afatgjata

Parapagimet afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Garanci për ambjentet e marra me qira	12,234,270	7,724,310
	12,234,270	7,724,310

9. Investime në ambjente të marra me qira

Investimet në ambjentet e marra me qira detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Investime në ambjente të marra me qira	72,496,039	92,591,510
	72,496,039	92,591,510

Vlera e investimeve të kryera në ambjente të marra me qira, amortizohet mbi bazën e kohëzgjatjes së kontratës.

CONAD FOOD TRADE sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

10. Inventarë

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mallra	248,504,574	271,715,647
Inventar i imët	10,160,917	10,160,917
Zhvlerësim inventari imët	(3,703,614)	(3,703,614)
	<u><u>254,961,877</u></u>	<u><u>278,172,950</u></u>

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarëve

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Gjendja më 1 janar	(3,703,614)	(3,338,313)
Rimarrje për vitin	-	-
Zhvlerësimi për vitin	-	(365,301)
Gjendja më 31 dhjetor	<u><u>(3,703,614)</u></u>	<u><u>(3,703,614)</u></u>

11. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë	20,797,107	14,171,700
	<u><u>20,797,107</u></u>	<u><u>14,171,700</u></u>

12. Llogari të arkëtueshme nga palë të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Conad Albania sh.p.k	60,414,957	27,755,058
	<u><u>60,414,957</u></u>	<u><u>27,755,058</u></u>

13. Llogaritë të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të tjera të arkëtueshme	6,518,366	9,369,060
	<u><u>6,518,366</u></u>	<u><u>9,369,060</u></u>

14. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime	3,705,900	3,359,757
Shpenzime të shtyra për tu shpërndarë në disa periudha	3,515,227	3,783,620
	<u>7,221,127</u>	<u>7,143,377</u>

15. Mjete monetare në arkë e në bankë

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	<u>96,110,418</u>	<u>21,379,229</u>
Në Lekë	78,684,358	17,185,260
Në monedhë	17,426,060	4,193,969
Mjete monetare në arkë	<u>39,977,010</u>	<u>106,001,411</u>
Në Lekë	39,977,010	106,001,411
Në monedhë	-	-
	<u>136,087,428</u>	<u>127,380,640</u>

16. Kapitali

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Luan Leka	131,087,880	131,087,880
Conad Adriatico Societa Cooperativa	17,875,620	17,875,620
	<u>148,963,500</u>	<u>148,963,500</u>

Rezerva ligjore

Rezervat ligjore të shoqërisë më 31 dhjetor 2018 kanë qenë në vlerën 2,974,975 Lekë (2017: 1,101,320 Lekë).

Fitim/(Humbje) të mbartura

Shuma prej 21,765,887 Lek përfaqëson fitimin e mbartur nga viti parardhës (2017: (13,833,551) Lek përfaqëson fitimin e mbartur nga viti parardhës).

Fitimi/(humbje) i/(e) ushtrimit

Shuma prej 86,633,938 Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit përgjatë vitit 2018.

17. Huaja afatgjatë

Huaja afatgjatë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua afatgjatë	-	10,382,973
	<u>-</u>	<u>10,382,973</u>

18. Hua afatgjatë nga ortakët

Huaja afatgjatë përbëhet më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua nga ortakët	55,595,845	59,888,734
	<u>55,595,845</u>	<u>59,888,734</u>

19. Hua afatshkurtër

Huaja afatshkurtër përbëhet më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Overdraft Intesa SanPaolo	-	663,324
Overdraft American Bank of Investment	-	174
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	8,025,123	25,770,927
	<u>8,025,123</u>	<u>26,434,425</u>

Shoqëria ka hyrë në marrëdhënie huaje me Intesa San Paolo Bank, norma e interesit për huanë është e barabartë me normën vjetore të EURIBOR 1 mujor + një normë prej 2%, por asnjëherë përqindja e interesit nuk mund të jetë më pak se 3%.

20. Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të pagueshme tregtare	60,434,382	75,761,855
Furnitorë për fatura të pambërritura	9,065,364	9,662,707
	<u>69,499,746</u>	<u>85,424,562</u>

CONAD FOOD TRADE sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

21. Llogari të pagueshme nga palët të lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
E.H.W sh.p.k	6,305,760	5,067,689
Conad Shqipëria sh.p.k	-	232,220
Conad Albania sh.p.k	336,246,242	444,716,998
	<u>342,552,002</u>	<u>450,016,907</u>

22. Parapagimet e arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime nga klientë	73,563	75,678
	<u>73,563</u>	<u>75,678</u>

23. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,427,468	2,536,130
Tatimi mbi të ardhurat personale	805,455	774,433
Tatim në burim	650,561	778,758
TVSH për t'u paguar	21,245,911	22,237,123
Detyrim tatim fitimit	8,795,504	3,589,646
	<u>33,924,899</u>	<u>29,916,090</u>

24. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga të pagueshme	9,286,556	9,245,803
Të tjera të pagueshme	318,267	-
	<u>9,604,823</u>	<u>9,245,803</u>

CONAD FOOD TRADE sh.p.k
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

25. Të ardhura

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	2,419,967,952	2,319,702,863
	<u>2,419,967,952</u>	<u>2,319,702,863</u>

26. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura të tjera	2,460,873	4,447,268
Të ardhura nga qeraja	28,457,762	32,214,800
	<u>30,918,635</u>	<u>36,662,068</u>

27. Materiale të para dhe të konsumueshme

Në këtë zë paraqitet kostoja e mallrave të shitur që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Kostoja e mallrave të shitur paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Mallra	1,820,514,928	1,774,841,013
Ndryshim gjendje inventari	23,211,073	14,542,143
	<u>1,843,726,001</u>	<u>1,789,383,156</u>

28. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime paga	111,381,963	102,324,366
Shpenzime për sigurime shoqërore	16,674,141	16,137,562
	<u>128,056,104</u>	<u>118,461,928</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 219 punonjës (2017: 231 punonjës).

29. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime amortizimi	71,717,591	77,560,517
Shpenzime rimarrje kuotash investimi në ambjente me qira	22,560,708	17,000,536
Shpenzime zhvlerësimi	1,784,828	-
	<u>96,063,127</u>	<u>94,561,053</u>

30. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Blerje energji, avull, ujë karburant	36,137,534	35,558,240
Shpenzime transporti personeli e të tjera	15,734,979	14,877,341
Mirëmbajtje dhe riparime	15,107,173	20,727,211
Sigurime	11,143,707	14,712,315
Udhëtime e dieta	243,940	50,920
Shpenzime administrative	36,077,271	37,364,458
Qera	140,130,914	151,650,828
Shpenzime ligjore e konsulenca	3,550,919	1,009,136
Lëndë djegëse	848,288	1,667,745
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,290,593	1,547,648
Publicitet, reklama	58,000	152,641
Komisione dhe tarifa bankare	3,821,618	5,384,366
Tatime dhe taksa të tjera	8,929,628	7,417,823
Pagesa për honorare, ndërmjetës	-	675,400
Gjoha e demshperblime	332,544	179,765
Të tjera shpenzime	12,256,787	16,867,719
Uniformat e punonjësve	1,301,588	1,039,833
Humbje nga shitja e aktiveve afatgjata	-	208,926
	<u>286,965,483</u>	<u>311,092,315</u>

31. Shpenzime dhe të ardhurat nga interesi dhe te ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime per interesa hua	(272,256)	(1,854,398)
Të ardhura nga interesat	23,819	9,557
	<u>(248,437)</u>	<u>(1,844,841)</u>

32. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Humbjet nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime nga këmbimet valutore	1,124,712	662,034
Të ardhura nga këmbimet valutore	(7,687,017)	(3,452,120)
	<u>(6,562,305)</u>	<u>(2,790,086)</u>

33. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Fitimi para tatimit	102,389,740	43,811,724
Total shpenzime të panjohura	2,648,942	2,853,776
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	332,544	179,765
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	1,784,828	-
Shpenzime zhvlerësimi nga mbyllja e dyqanit	-	2,108,023
Shpenzime të tjera të pazbritshme	531,570	565,988
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	105,038,682	46,665,500
Humbje fiskale e mbartur	-	(4,407,957)
Fitimi i tatueshëm	105,038,682	42,257,543
Tatim fitimi @15%	15,755,802	6,338,631
	<u>86,633,938</u>	<u>37,473,093</u>

34. Palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet e mëposhtme vijnë nga aktiviteti i përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
CONAD ALBANIA shpk	60,414,957	336,246,242	27,755,058	444,716,998
Conad Shqiperia shpk				232,220
EHW shpk		6,305,760		5,067,689
	60,414,957	342,552,002	27,755,058	450,016,907

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Conad Albania shpk	93,410,950	2,000,045,409	78,030,451	1,617,161,327
EHW shpk	-	31,662,802	1,650,864	35,965,272
Conad Shqiperia shpk	-	3,274	-	-
Qafshatama shpk	136,808	-	175,982	-
	93,547,758	2,031,711,485	79,857,297	1,653,126,599

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti i përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe çmime të përafërta me ato të tregut .

Përveç përfitimeve afatshkurtra ndaj ekipit manaxhues të Shoqërisë, në shumën 1,777,056 Lekë nuk janë dhënë kompensime të tjera ndaj menaxhimit .

35. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

35. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë, për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve, që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

	31 dhjetor	
	2018	2017
Instrumenta me interesa fiks		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	-
Instrumenta me interesa variable		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	10,382,973
	-	10,382,973

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat, institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Përshkrimi	31 dhjetor 2018				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	71,096,205	13,949,171	2,685,054		87,730,430
Mjete monetare në arkë dhe bankë	136,087,428				136,087,428
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2018	207,183,633	13,949,171	2,685,054	-	223,817,858

Përshkrimi	31 dhjetor 2017				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	45,269,204	1,727,724	4,298,890		51,295,818
Mjete monetare në arkë dhe bankë	127,380,640				127,380,640
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2017	172,649,844	1,727,724	4,298,890	-	178,676,458

35. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë, pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristikë likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do t'i duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor, që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

31 dhjetor 2018

Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	87,730,430				87,730,430
Mjete monetare në arkë dhe bankë	136,087,428				136,087,428
Totali	223,817,858				223,817,858
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(455,581,470)				(455,581,470)
Hua	(8,025,123)			(55,595,845)	(63,620,968)
Totali	(463,606,593)			(55,595,845)	(519,202,438)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	(239,788,735)			(55,595,845)	(295,384,580)

31 dhjetor 2017

Përshkrimi	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	51,295,818				51,295,818
Mjete monetare në arkë dhe bankë	127,380,640				127,380,640
Totali	178,676,458				178,676,458
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(574,603,362)				(574,603,362)
Hua	(15,005,444)	(13,167,163)	(8,644,791)	(59,888,734)	(96,706,132)
Totali	(589,608,806)	(13,167,163)	(8,644,791)	(59,888,734)	(671,309,494)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2017	(410,932,348)	(13,167,163)	(8,644,791)	(59,888,734)	(492,633,036)

35. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2018			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	87,730,430		87,730,430
Mjete monetare në arkë dhe bankë	17,426,060	118,661,368		136,087,428
Totali	17,426,060	206,391,798	-	223,817,858
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(7,717,477)	(447,895,881)		(455,613,358)
Hua	(63,620,968)	-		(63,620,968)
Totali	(71,338,445)	(447,895,881)	-	(519,234,326)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	(53,912,385)	(241,504,083)	-	(295,416,468)

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera		51,295,818		51,295,818
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,772,036	122,608,604		127,380,640
Totali	4,772,036	173,904,422	-	178,676,458
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(9,503,505)	(565,099,857)		(574,603,362)
Hua	(34,415,892)	(62,290,240)		(96,706,132)
Totali	(43,919,397)	(627,390,097)	-	(671,309,494)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2017	(39,147,361)	(453,485,675)	-	(492,633,036)

36. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të Shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

37. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

38. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018, Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

39. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Më datë 07.03.2019 shoqëria vendosi të ndryshoj emrin nga FOOD TRADE shpk në CONAD FOOD TRADE shpk.

Tiranë më, 29.03.2019


VËRTETIM

Me anë të kësaj shkresë vërtetojmë se MAZARS sh.p.k është angazhuar për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë "**Conad Food Trade shpk**" me NIPT K61704029H dhe seli të regjistruar në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.6, Magazina nr.1 për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2018.


Ne nuk e kemi përfunduar ende procesin e auditimit dhe në këtë moment nuk jemi në gjendje të lëshojmë raportin e auditimit.

E lëshojmë këtë vërtetim, sipas kërkesës së shoqërisë "**Conad Food Trade shpk**".

MAZARS sh.p.k
Shoqëri Audituesish ligjor

 MAZARS

Rr. Emin Duraku Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al . info@mazars.al



Irena Hoxha (Pulo)
Partner Angazhimi